

Harta Qymyrove e Kosovës

Pjesa produktive e Basenit Qymyror të Kosovës e përshkon në tërësi komunën e Fushë-Kosovës. Baseni Qymyror i Kosovës (pjesa qendrore) shtrihet prej fshatit Mihaliq në veri, deri te Lipjani në jug, me gjatësi rreth 30 km. Linjiti i Basenit të Kosovës përmban: strukturë drunore (ksilit) rreth 65 %, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga qymyrdheu, lagështi deri në 50 %, sulfur (1-1,5) % etj. Komuna e Fushë-Kosovës i takon pjesës qendrore të territorit të Republikës së Kosovës me një sipërfaqe prej 83 km², e përfaqësuar nga qyteti i Fushë-Kosovës me fshatrat: Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh, Pomozotin, Bardh i Vogël, Sllatinë e Vogël, Sllatinë e Madhe, Harilaç, Henc, Vragoli, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Kuzmin dhe Lismir.

Komuna e Fushë-Kosovës ka rezerva të mëdha të linjtit, që shtrihen prej fshatrave Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh në VP, përmes fshatit Lismir deri në JL të qytetit të Fushë-Kosovës. Në komunën e Fushë-Kosovës kemi një Minierë Sipërfaqësore në Bardh të Madh, e cila është aktive në shfrytëzimin e linjtit.

MS “Kosova” në Bardh të Madh punët përgatitore i ka filluar më 1964.


Me shfrytëzimin e qymyrit filloi në vitin 1969, kurse prodhimin më të lartë e arriti në vitin 1988.

Miniera e Bardhit shtrihet në kufirin perëndimor të Basenit Qymyror të Kosovës. Në pjesën veriore Miniera e Bardhit kufizohet me fshatin Hade, në veriperëndim me fshatin Graboc i Poshtëm, në jug me fshatin Bardh i Madh, kurse në lindje me Minierën Sipërfaqësore të Mirashit. Ndërtimi gjeologjik i Minierës së Bardhit është pjesë e ndërtimit gjeologjik të Basenit Qymyror të Kosovës dhe karakterizohet nga këto seri:

Seria tavanore: Argjilë ngjyrë hiri - shumë e përhapur me shumë fosile, argjilë e verdhë, zall ngjyrë kafeje, shtresa humusore;

Seria qymyrore: Qymyr, ksilit, mergel;

Seria dyshemore: Argjilë e gjelbërt - pjesërisht ranor, tejet kompakte.



Bazën e Bazenit të Kosovës e përbëjnë shkëminjtë kristalorë Palezoik dhe Mesozoik.

Qymyri është i shtrirë në argjila terciere.


Në përfundim Bazeni kufizohet nga prishjet me shtrirje VVP-JJL.

Në lindje trashësia e serisë qymyrore pakësohet dhe pykëzohet.

Harta e Basenit Qymyror të Kosovës

Pra, siç shihet nga harta e Basenit Qymyror të Kosovës, territori i Komunës së Fushë-Kosovës shtrihet komplet mbi Basenin Qymyror të Kosovës dhe trashësia mesatare e qymyrit në komunën e Fushë-Kosovës arrin 60-80 m.

Në afërsi të Minierës së Bardhit kalon Hekurudha Fushë-Kosovë – Pejë, me të cilën miniera është e lidhur me binarë industrial nga fshati Bardh i Madh, që shërben për transportimin e pajisjeve dhe pjesëve rezervë. Paralel me hekurudhën kalon rruga automobilistike që lidh minierën me rrugët tjera kryesore: Fushë-Kosovë/Pejë dhe Prishtinë/Mitrovicë.



Pjesa veriore e Basenit të Kosovës ndahet në vendburimet Mirash, Bardh dhe Sibofc.

Punimet minerale filluan në vitin 1920 në gërmim nëntokësor kurse që prej vitit 1959 qymyri nxirret në minierë sipërfaqësore.

Mosha e qymyrit: 9 Milion vjet

Miniera Qymyrore e Bardhit të Madh menaxhohet nga KEK-u

Shfrytëzimi i qymyrit bëhet me ekskavatorë, me shumë kova (ekskavatorë rrotorik), të kapaciteteve të ndryshme, ndërsa transporti i qymyrit prej minierës deri në TC "Kosova B" realizohet me shirita transportues të gomës. Pas luftës palosja e mbulesës është e brendshme në hapësirën e shfrytëzuar të minierës në anën jugore.



Pamje e shtresës qymyrove në Minierën Sipërfaqësore në Bardh të Madh